IKTK
INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT

Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore

GJURMA MUJORE

Korrik 2026

Kulla e Turanit rikthehet në identitetin e saj historik

Vëzhgimin arkeologjik sipërfaqësor në zonën e Fierit

Vëzhgim arkeologjik sipërfaqësor, qarku Korçë

Restaurim; Ujësjellësi Historik i Vranishtit, Himarë

Takim, Kisha e Shën Kollit, Krutje e Sipërme

Fillimi i punimeve; Qendra e vizitorëve, Bylis

Inspektim; Ura e Zotos, Vithkuq, Korçë

Zbulim arkeologjik; fshati Rromës, Selenicë

Evidentim i një mbishkrimi në Manastirin e Ardenicës

Botimi nr. 07

IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Kulla e Turanit rikthehet në identitetin e saj historik.

Pak muaj më parë njoftuam nisjen e punimeve restauruese, me angazhimin për të shpëtuar dhe rikthyer në dinjitet një prej monumenteve më të rëndësishme të zonës së Korçës. Sot, falë investimit të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore dhe realizimit të projektit në bashkëpunim me DRTK Korçë, ky angazhim është bërë realitet. Kanë përfunduar punimet restauruese në Kullën e Turanit, ku u realizuan ndërhyrje për konsolidimin e strukturës, restaurimin e elementëve arkitekturorë dhe mbrojtjen e monumentit nga degradimi, duke respektuar autenticitetin dhe teknikat tradicionale të ndërtimit.

Ky restaurim është një tjetër hap konkret në misionin e IKTK-së për mbrojtjen, restaurimin dhe promovimin e trashëgimisë kulturore shqiptare.





IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.











IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Vëzhgimin arkeologjik sipërfaqësor në zonën e Fierit

Në kuadër të shërbimeve që IKTK tashmë ofron, specialistët e Drejtorisë së Shërbimit Arkeologjik realizuan gjatë datave 7–11 korrik vëzhgimin arkeologjik sipërfaqësor në zonën e Fierit, në fshatrat Drizë, Peshtan, Frakull e Madhe dhe Kafaraj, në kuadër të projektit të OST sh.a. për rikonstruksionin e linjës Fier–Kafaraj 110 kV.

Gjatë punës në terren u krye dokumentimi arkeologjik i territorit përgjatë gjurmës së projektit, duke kontribuar në evidentimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore gjatë zbatimit të investimit.

Subjektet mund të aplikojnë online për shërbimin “Raporti i Vëzhgimit Arkeologjik” përmes portalit e-Albania në linkun: https://e-albania.al/ServiceDetails/13701



IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.











IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.









IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Vëzhgim arkeologjik sipërfaqësor, qarku Korçë

IKTK vijon të ofrojë shërbimin e vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor për projektet zhvillimore. Së fundmi, specialistët e Drejtorisë së Shërbimit Arkeologjik realizuan vëzhgimin përgjatë gjurmës së projektit "Linja Elektrike 110 kV dhe Nënstacioni Ngritës Qarr–Kozel 110/35 kV", me kërkesë të subjektit "Albpower" sh.p.k., në Qarkun Korçë.

Vëzhgimi u zhvillua në fushën e Korçës, në drejtim të vargmalit që shtrihet drejt fshatit Kozel, si dhe në sipërfaqet e parashikuara për vendosjen e shtyllave dhe ndërtimin e nënstacioneve. Gjatë punës në terren u krye dokumentimi arkeologjik i territorit, me qëllim identifikimin dhe evidentimin e çdo gjurme të mundshme të trashëgimisë kulturore, duke kontribuar në mbrojtjen e saj gjatë realizimit të projektit.

Shërbimi i vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor është pjesë e veprimtarisë së IKTK-së për garantimin e ruajtjes dhe menaxhimit të qëndrueshëm të trashëgimisë kulturore gjatë zbatimit të projekteve zhvillimore.

Subjektet mund të aplikojnë online për shërbimin "Raporti i Vëzhgimit Arkeologjik" përmes portalit e-Albania, linku i shërbimit: https://e-albania.al/ServiceDetails/13701





IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.











IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Restaurim; Ujësjellësi Historik i Vranishtit, Himarë

Ujësjellësi Historik i Vranishtit, në Bashkinë Himarë, një trashëgimi e vyer e historisë dhe mjeshtërisë ndërtimore shqiptare, po i nënshtrohet punimeve të restaurimit dhe mirëmbajtjes për të garantuar ruajtjen e tij për brezat që vijnë.

Ndërhyrjet kanë përfshirë pastrimin dhe konsolidimin e muraturës historike, restaurimin e elementëve të dëmtuar, fugatimin me materiale tradicionale, hidroizolimin e kanalit, rehabilitimin e harqeve dhe parapeteve, si edhe punime të kujdesshme për të garantuar qëndrueshmërinë afatgjatë të monumentit.

Çdo fazë e punimeve është realizuar nën mbikëqyrje teknike dhe në përputhje me standardet e restaurimit të trashëgimisë kulturore, duke ruajtur autenticitetin dhe vlerat historike të kësaj vepre të rrallë inxhinierike.











IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Takim, Kisha e Shën Kollit, Krutje e Sipërme

Përfaqësues të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore zhvilluan një takim pune me administratorin e Njësisë Administrative Krutje e Sipërme, Lushnje, për mbrojtjen dhe restaurimin e Kishës së Shën Kollit, Monument Kulture i Kategorisë I.
Gjatë takimit u prezantua projekti i restaurimit dhe ndërhyrjet e planifikuara për ruajtjen, konsolidimin dhe restaurimin e monumentit, si dhe puna e IKTK për dokumentimin, studimin dhe ndjekjen e procedurave të nevojshme për zbatimin e tij.
U theksua rëndësia e Kishës së Shën Kollit për trashëgiminë kulturore dhe identitetin historik të zonës, si edhe nevoja për bashkëpunim institucional dhe me komunitetin vendor për mbështetjen e procesit të restaurimit.
Takimi rikonfirmoi angazhimin për ruajtjen dhe restaurimin e këtij monumenti, me synimin që kjo pasuri e vyer e trashëgimisë kulturore shqiptare t'u përcillet brezave të ardhshëm.







IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Fillimi i punimeve; Qendra e vizitoreve, Bylis

Specialistët e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore morën pjesë në fillimin e punimeve për ndërtimin e Qendrës së Vizitorëve në Parkun Arkeologjik të Bylisit, një investim i rëndësishëm që synon përmirësimin e infrastrukturës, shërbimeve për vizitorët dhe menaxhimin e një prej pasurive më të rëndësishme të trashëgimisë kulturore në vend.

Ky investim realizohet në kuadër të projektit për vlerësimin dhe zhvillimin e Parkut Arkeologjik të Bylisit, me synim krijimin e një infrastrukture moderne që do të forcojë interpretimin, ruajtjen dhe promovimin e parkut, duke e bërë atë më të aksesueshëm dhe më tërheqës për vizitorët.









IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Zbulim arkeologjik; fshati Rromës, Selenicë

Në fshatin Rromës, Bashkia Selenicë, gjatë punimeve për ndërtimin e një depoje uji u zbuluan rënojat e një çezme të vjetër, e cila, bazuar në tiparet arkitekturore dhe gjetjet paraprake, mendohet të datohet në shek. XV–XVI.

Dokumentimi i këtij zbulimi, i mundësuar falë bashkëpunimit të banorëve me specialistët e DRTK Vlorë, përbën një kontribut të rëndësishëm në evidentimin dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore të zonës.











IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Inspektim; Ura e Zotos, Vithkuq, Korçë

Në kuadër të monitorimit të vazhdueshëm të monumenteve të kulturës, specialistët e IKTK-së zhvilluan një inspektim në Urën e Zotos, monument kulture i kategorisë së I-rë, në fshatin Vithkuq, Korçë.

Gjatë inspektimit u evidentuan problematika të konservimit dhe faktorë natyrorë që ndikojnë në gjendjen e monumentit, duke nxjerrë në pah nevojën për ndërhyrje mirëmbajtëse e konservuese.

IKTK mbetet e angazhuar në mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e Urës së Zotos, me synim ruajtjen e integritetit, autenticitetit dhe vlerave të saj historike e arkitekturore për brezat e ardhshëm.







IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Evidentim i një mbishkrimi në Manastirin e Ardenicës

Gjatë një inspektimi në terren, specialistët e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK) zhvilluan një verifikim në Manastirin e Ardenicës, në Kishën "Lindja e Shën Mërisë", ku u evidentua një mbishkrim me shkronja greke në portikun e kishës. Në mbishkrim dallohen fjalët «ΔΙΜΑΛΛΑC ΝΙΚ» dhe përbën një element me interes për monumentin.

Manastiri i Ardenicës, përmban disa faza ndërtimi, më e hershmja prej të cilave i përket periudhës bizantine. Oborri i Manastirit zihet në pjesën më të madhe nga kisha "Lindja e Shën Mërisë" e rindërtuar në vitin 1743 dhe e rrethuar nga konakë. Kisha përbëhet nga naosi, narteksti, dy hajate të hapura dhe nga kulla e kambanares. Kisha që përbën ndërtimin krysor të këtij asambli është e tipit të thjeshtë bazilikal me hapësire volumore të madhe. Në veri të saj ndodhet kisha e vjetër e Shën Triadhës, rindërtuar në vitin 1922.







IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.











IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.